



Republika e Shqipërisë
KOMITETI I PAJTIMIT MBARËKOMBËTAR

Addressa: Rr. "M. Muça", Pall. 46, Ap. 23, Tiranë, Albania
Tel & Fax 00355 42 263 126. Tel 00355 42 259 124, Mobile: 00355 68 27 37 989 / 00355 69 32 38 786
E-mail gjin_marku@yahoo.com, gjin_marku@pajtimi.com, gjin_marku@hotmail.com
Web: www.pajtimi.com

R A P O R T
I KONGRESIT TË KATËRT TË MISIONARËVE TË PAJTIMIT
Për integrimin në BE me kulturën e ligjit, të paqes e të bashkëjetesës

Tiranë më 4 Shtator 2013



Kongresi si forumi i lartë

Kongresi i misionarëve të pajtimit është forumi më i lartë i misionarëve, që thirret një herë në 4 vjet nga Komitetit i Pajtimit Mbarëkombëtar për orientimin e tyre në procesin e pajtimit. Kongresi miraton planin 4 vjeçar të punës së Komitetit dhe të Asamblesë Kombëtare të Misionarëve të Pajtimit që udhëhiqet nga ky Komitet. Asambleja përbëhet nga misionarët e zgjedhur nga degët e rretheve. Komiteti i Pajtimit Mbarëkombëtar udhëheq ekspeditat vjetore të pajtimit në bashkëpunim me anëtarët e asamblesë dhe grupet e punës që janë ngritur në 2800 fshatra, 60 bashki e 300 komuna.

Grupet e punës së Komitetit janë të përbëra nga misionarët më me reputacion, përfaqësues të pushtetit vendor dhe të arsimit. Këto grupe bashkërendojnë punën me përfaqësuesit e policisë në qarqe dhe mbajnë kontakte me degët dhedy rezidenat kryesore të Komitetit, Rezidenca e Veriut me qendër në Pukë dhe Rezidenca e Jugut me qendër në Lushnjë. Procesi i pajtimit realizohet nëpërmjet kontakteve të vazhdueshmetë grupeve të punës me familjet në hasmëri dhe takimit të ekspeditave me fiset etyre për të avancuar procesin deri në pranimin e faljes dhe finalizimin e pajtimit.

Zhvillimi i Kongresit të Katërt

Kongresi i Katërt i Misionarëve të Pajtitimit thirrme datë 4 shtator 2013, në Akademinë e Arteve, në bashkëpunim me Federatën Universale të Paqes e të Familjes, Institutin Kombëtar të Integritimit të Jetimëve Shqiptarë dhe Unionin Mbarëkombëtar të të Burgosurve dhe të Përndjekurve Politikë. Kongresi u mbledh me pjesëmarrjen e anëtarëve të asamblesë dhe përfaqësues të Komitetit nga Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia. Kongresi i zhvilloi punimet në prani të mediave, të përfaqësuesve të shtetit shqiptar, të shoqërisë civile dhe të organizatave ndërkombëtare. Kongresi aprovoi raportin dhe planin për lirim pa kushte të grave dhe fëmijëve të ngjuar, i cili do u dërgohet institucioneve vendore dhe ndërkombëtare.

Dokumentet e Kongresit nuk shërbejnë vetëm për orientimin e misionarëve në procesin e pajtitimit, por edhe për promovimin e kulturës së ligjit dhe nxitjen e strukturave shtetërore në kryerjen me përgjegjësi të detyrës ndaj publikut, sensibilizimin e qytetarëve që të bashkëpunojnë me qeverinë, institucionet e shtetit, dhe policinë në luftën kundër krimit.

Kongresi shqyrtoi dhe miratoi platformën e Memorandumit të Bashkëpunimit të Komitetit të Pajtitimit Mbarëkombëtar me Ministrinë e Brendshme të Republikës së Shqipërisë

Procesi i pajtitimit.

Bashkëpunimi dhe vendim marrja në komunitet, kyçi i parandalimit të vrasjeve.

Komiteti i Pajtitimit Mbarëkombëtar udhëheq e organizon procesin e pajtitimit në shkallë kombëtare. Ai ngre çdo vit ekspeditat e pajtitimit në të gjitha rrethet e vendit, për të afruar dialogun midis familjeve në hasmeri dhe parandalimin e vrasjeve.

Ekspeditat funksionojnë me plan vjetor, disa mujor, si dhe plane aftashkurtëra në prag festash fetare e kombëtare. Ato janë organizuar mbi baza vullnetare pa asnjë mbështetje nga donatorët apo shteti shqiptar dhe punojnë me efektivitet si në parandalimin e vrasjeve edhe në përhapjen e kulturës së ligjit. Ekspeditat mobilizojnë grupet e përherëshme të punës së Komitetit të Pajtitimit Mbarëkombëtar nëpër fshatra, të udhëhequra nga një misionar, përfaqësuesi i shkollës dhe përfaqësuesi i pushtetit vendor. Këto grupe vullnetare punë ndjekin dhe mbajnë nën kontroll situatën e konflikteve e të hasmërive në 2800 fshatra, 60 Bashki e 300 komuna. Kjo strukturë është bërë tradicionale dhe vepron në mënyrë aktive e të përherëshme në terren.

Shtabi qëndror i Ekspeditave, që përbëhet nga 11 deri në 24 misionarë së bashku me drejtuesit e Komitetit, kontakton herë pas here familjet në hasmëri deri në finalizimin e pajtitimit. Në momente kyçe rreth shtabit qëndror të ekspeditës mobilizohen 24 deri në 60 misionarë. Ekspedita e pajtitimit kërkon vëllazërimin e familjeve në hasmëri pa penguar drejtësinë, duke kërkuar dënimin e krimit sipas ligjit dhe pendimin e fajtorit.

Ekspierienca e Komitetit të Pajtitimit Mbarëkombëtar ka sjellë në çdo rast pajtimin afatgjatë e të përherëshëm të familjeve. Komiteti ka gjetur mbështetjen e të gjithë qytetarëve si në jug edhe në veri të vendit. Në sajë të kësaj mbështetje ekspeditat kanë mundur të realizojnë çdo vitzgjidhjen me marrëveshje e pajtimin e 30- 40 % të konflikteve e hasmërive. Bazuar në eksperiençën e gjere, para e pas pluralizmit politik, në ngjarjet e vitit 1990-92, 1997 e në vitin 2011, Komiteti ka hartuar strategjinë afatgjatë të punës së tij për paqen dhe bashkjetesën midis shqiptarëve, për zgjidhjen e konflikteve me mirëkuptim dhe parandalimin e vrasjeve. Deri në vitin 2008, si rezultat i punës vullnetare të grupeve të Komitetit dhe mbështetjes së institucioneve e të policisë së shtetit, numri i vrasjeve u ul nga 450 e 600, në 70- 80 në vit. Puna e tyre ka ndihmuar edhe në parandalimin e konfliktet sociale si në vitin 1997 kur misionarët bindën familjet në veri për të mos çuar djemtë e armatosur në luftë kundër protestuesve në jug.

Mbas vitit 2008, qëndrimi i i njëanshëmi qeveritarëve e ndërprerja e bashkëpunimit me Komitetin e Pajtitimit Mbarëkombëtar për shkak të kritikave që Komiteti i bëri keq-qeverisjes e ka dëmtuar procesin e pajtitimit e dyfishuar numrin e vrasjeve, nga 70-80 në 150 në vit. Edhe pas ndërprerjes së këtij bashkëpunimi, ekspeditat e pajtitimit vazhduan punën pa mbështetje duke bërë të mundur që numri i familjeve të ngujuara të zbresë nga 1670 në 1208, ndërsa numri i fëmijëve që nuk shkojnë në shkollë nga 911 në 590. Ekspeditat kanë bërë lirin pa kushte të grave e fëmijëve në zonat Pukë, Has, Kukës, Malsi e Madhe, Postribë, Mirditë, Dukagjin, Iballë, Malësi e Lezhës e Malësi e Tiranës. Në këto zonat funksionuar nxitja e ekspeditës në ndërgjegjësimin e qytetarëve për të respektuar traditën e mirëkuptimit dhe vendimmarrjes në komunitet.

Ekspeditat kanë konstatuar se në zonat tradicionale ku respektohet tradita e vendimmarrjes në komunitet si; Malësi e Madhe, Postribë, Mirditë, Kukës, Pukë, Has, Dibër etj, qytetarët jo vetëm që e ruajnë traditën e faljes e të pajtitimit por e zbatojnë ligjin më tepër se në metropole. Administrata e këtyre zonave mbetet e pakorruptuar dhe gëzon respekt në shërbimet ndaj qytetarëve. Dialogu e vendimmarrja në komunitet është kyçi që ata i ka ndihmuar për të eliminuar konfliktet e hasmëritë, si dhe zhvilluar ekonomitë e tyre bujqësore, blegtorale e pyjore pa rivelitete e tendenca regresive.

Gjendja e shoqërisë shqiptare

Përpjekjet për anëtarësimin në BE

Shqipëria po bën përpjekje për tu anëtarësuar në Bashkimin Europian por gjendja shoqërore e politike e vendit nuk ka përparuar siç e kërkojnë standartet e këtij anëtarësimi. Qeveria ka bërë reforma ligjore, por ato janë vetëm në letër dhe nuk implementohen. Në mungesë të drejtësisë dhe të institucioneve efikase të shtetit ligjor, Shqipëria përballet me aplikimin e të bërit drejtësi nëpërmjet vetëgjyqësisë, te ashtuquajtur gjakmarrje - një fenomen i rëndë që ka vënë në rrezik jetën e shumë qytetarëve. Shqipëria është i vetmi vend në Europë ku njerëzit vriten për të paguar krimin që ka bërë një i afërm i tyre, qoftë edhe shumë vite më parë. Kjo ka bërë që një numër i madh qytetarësh të ngujohen e fshihen, si masë sigurie për jetën e tyre të kërcënuar nga vrasësi, ose të largohen nga Shqipëria.

Vrasjet kryhennën një mentalitet të deformuar kanunor, që nuk kanë lidhje me gjakmarrjen, natyrën dhe rregullat e saj, sepse bëhen në kundërshtim të plotë me kanunin. Vrasjet e tranzicionit për pronën, për nderin, për hakmarrje e gjakmarrje janë ngritur si shqetësim edhe nga Asambleja e Kombeve të Bashkuara.

Rrënimi i vlerave

Klasa politike gjatë tranzicionit, jo vetëm nuk ka luajtur rol pozitiv për ruajtjen e promovimin e vlerave dhe virtyteve të shqiptarëve si mikpritja, bujaria, besa, marrëdhëniet e mira ndëretnike, toleranca fetare, solidariteti, respektimin e rregullave në komunitet etj. por i ka rrënuar ato me orientimin e gabuar të shoqërisë drejt çorganizimit, manipulimit të votës e konflikteve, duke nxitur urrejtje e ndasi, që kulmuan në vitin 1997 drejt një lufte civile me rreth 3000 të vrarë, dhe në vitin 2011 me përplasjen e qeverisë me protestuesit ku mbetën të vrarë 4 qytetarë e u plagosën dhjetra të tjerë. Zgjedhjet elektorale vazhdojnë të sjellin akoma përplasje e vrasje të cilat shoqërohen me veprime për shitblerjen e votës.

Për shkak të korrupsionit e krimin të organizuar, të lidhur me nivelet më të larta në qeveri dhe gjithë administratën publike, Shqipëria ka hyrë në një krizë të gjithanshme që qeveria, në pamundësi për ti dhënë zgjidhje, tenton ta fshehë përpara opinionit dhe institucioneve ndërkombëtare. Komiteti i Pajtitimit Mbarëkombëtar gjithmonë ka ngritur çdo

çështje që e konsideron të rëndësishme për konsolidimin e demokracisë pranë cdo institucioni relevant, të huaj dhe të brendshëm, pasi vetëm përballja me problemet e vendit mund të ofrojë zgjidhje afatgjatë. Ky qëndrim i yni shpesh herë ka bërë që qeveria, në tentativë për të fshehur gjendjen reale të fenomenit të vrasjeve, pasi ky fenomen behet pengesë për pseudo-arritjet në proceset e integritit, ka sulmuar hapur dhe në prapaskenë Komitetin e Pajtitimit Mbarëkombëtar. Integrimi i vertetë nuk është nënshkrimi i marrëveshjeve të realizuara mbi iluzione, por konsolidimi i demokracisë dhe shtetit ligjor. Integrimi në BE nuk duhet të jetë vetëm synim në vetëvete, por një udhërrëfyes dhe peshore e përparimit të demokracisë dhe prandaj manipulimi i peshores nëpërmjet fshehjes së realitetit nuk i shërben integritit të vertetë mes kombeve të qytetëruara me demokraci funksionale.

Dhuna në familje dhe ndaj gruas.

Dhuna në familje që kulmon me vrasjen e grave e vajzave është e paprecedent. Në vitet 2011, 2012 dhe gjatë vitit 2013 vrasjet e femrave janë dhjetëfishuar. Në vrasjet e femrave shfaqen edhe elementë të sadizmit e terrorit duke i masakruar në mënyrë çnjerëzore. Të tilla krime kanë qenë shumë të rralla në Shqipëri, dhe shtimi i tyre në vitet e fundit është shumë alarmant pasi janë shenja të një shoqërie që po humb normat dhe kohezionin social që, edhe në mungesë të shtetit ligjor, ndihmon në ruajtjen e rendit dhe bashkjetesën në harmoni.

Ekspertë të fushave të kriminalistikës, sociologjisë dhe psikologjisë duhet të hulumtojnë me thellë natyrën e këtyre vrasjeve dhe rritjen shqetësuese të numrit të tyre në mënyrë që të krijohet një strategji e qartë për një parandalim efikas të tyre në të ardhmen dhe ruajtjen dhe kultivimin e disa normave sociale dhe morale që mundesojnë krijimin e një shoqërie të shëndoshë, që respekton të drejtat e individit dhe barazinë gjinore.

Nxitja e urrejtjes fetare e kulturore.

Individë e grupe të manipuluar kanë nxitur vazhdimisht veprime kundër kulturës së trashëguar, tolerancës fetare e bashkjetesës ndëretnike. Herë pas here dhunohen objektet e kultit e varrezat si dhestisen debate publike e protesta pa qenë të nevojshme kundër ngritjes së xhamive apo kishave, në një kohë që gjithçka vendoset sipas ligjit. Shpesh shfaqen prirje përrevansh nga kleri me qëllim manipulimin e historisë e zgjerimin e rremë të territorit të fesë që i përkasin. Popullsia shqiptare është indiferente ndaj çështjeve fetare dhe këto sjellje i përcjellpa interes. Shqiptarët e respektojnë diversitetin fetar e kulturor dhe jetojnë me këtë diversitet edhe brenda familjes. Të rinjtë bashkëjetojnë pa e marrë fare parasysh se cilës fe i përket njëri apo tjetri. Objektet e kultit shihen nga qytetarët si objekte të kulturës së tyre të trashëguar që duhen respektuar, por jo me fanatizëm.

Shqiptarët kanë traditë të lashtë shtetformimi të mbështetur mbi multikulturalizmin, që nga Perandoria Ilire e shteti i Arbërit. Grupet etnike në atë perudhë gëzonin të drejta të barabarta me autoktonët dhe kulturat e popujve nga përdimimi e lindja gjenin shtratin e ngrohtë për kultivimin e lulëzimin e vlerave në trojet Ilire e të Arbërit. Kjo trashëgimi kulturore, e ruajtur deri në ditët e sotme me origjinalitetin e saj, larminë e valleve, lojrave, këngëve, instrumentave e veshjeve që pasurojnë jetën, ruajnë paqen, gëzimin e lumturinë mes qytetarëve, është lënë mbas dore nga qëndrimet e papërgjegjshme të politikës. Kjo pasuri e pazevëndësueshme, që në festivalet botërore merrte vlerësimet më të larta po zhduket dhe nuk po trashëgohet me krenari tek brezat e rinj siç ndodh në vende perëditore si Norvegjia, Suedia e Gjermania.

Fshehja e realitetit për interesat e politikës.

Që nga viti 1990 janë vrarë me vetëgjyqësi mijëra qytetarë të pafajshëm përfshirë edhe gra e fëmijë. Çdo vit, vetëm në spitalin Nënë Tereza në Tiranë, regjistrohen 600 -700 plagosje

me pasoja të rënda invaliditeti, 60 % e të cilave janë nga aksidentet, ndërsa 40 % nga armët e ftohta e të zjarrit. Aksidentet rrugore sjellin çdo ditë viktima, bilancin e të cilave Presidenca e Republikës e ka vlerësuar si një bilanc lufte dhe Qeveria Shqiptare nuk ka marrë asnjë masë për stabilizimin e qarkullimit apo ndalimin e ndërtimit të rrugëve që nuk kanë standartet minimale të sigurisë. Fshehja e problemit nga qeveria shqiptare për të mos humbur elektoratin dhe qeverisjen si dhe për të mos penguar anëtarësimin e Shqipërisë në BE ka përkeqësuar më tej gjendjen dhe shkon gjithnjë e më shumë në dëm të integritetit.

Varfëria si burim dhune.

Papërgjegjshmëria në qeverisje dhe pasoja në jetën e qytetarëve

Pozita gjeografike mesdhetare e Shqipërisë, me natyrën, relievin, klimen, bimësinë, ujrat dhe burimet nëntokësore, krijon kushte për jetesë të standarteve të larta dhe mundësi ekonomike tek çdo familje shqiptare, por këto pasuri nuk menaxhohen. Pavarësisht nga këto favore të natyrës, 60 % e shqiptarëve janë të varfër e të pasigurtë për të ardhmen. Vendi është futur në borxhe të thella për interesa të një grupi qeveritarësh e jo të qytetarëve që po kalojnë nga dita në ditë në krizë mosbesimi për të ardhmen e luftë për mbijetesë. Varfëria është bashkëudhëtare me krimet dhe një nga burimet kryesore të vrasjeve, vetvrasjeve, dhunës në familje e trafikimit të qënjeve njerëzore. Shumica e viktimave dhe e vrasësve janë nga familjet e varfëra, ashtu si dhe viktimat e vetvrasjeve. Familjet e varfëra mbeten më të konfliktuarat dhe më të rrezikuarat nga krimi. 20-25 % e viktimave të vetvrasjeve të raportuara nga policia janë për shkak të borxheve të pashlyera. Në të gjitha dyqanet ushqimore gjenden lista familjesh debitore që kanë edhe tre e gjashtë muaj pa likuiduar.

Pjesa më e rrezikshme e borxheve që kanë shkatërruar shume familje shqiptare janë borxhet që lindin nga bixhozi dhe kazinotë. Qeverisë i është prezantuar shqetësimi i shoqërisë civile se kazinotë janë një rrezik potencial për shoqërinë, por ministrat e lidhur me këto afera i kanë refuzuar kërkesat për mbylljen e tyre dhe i kanë shumëfishuar ato. Kjo situatë ka rënduar mbi jetën e shumë fëmijëve që mbeten pa përkraheje e shpesh herë jetimë.

Gjatë viteve të tranzicionit 12,000 fëmijë kanë braktisur shkollën që të punojnë për të ushqyer familjen ndërsa rreth 5,000 të tjerë kanë emigruar në vendet perëndimore. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre fëmijëve janë nga familjet në hasmëri. Në sajë të punës së ekspeditës së pajtimit për vitin 2013 është bërë e mundur që numri i fëmijëve të ngujuar që nuk mund të shkojnë në shkollë të zbresë nga 910 në 590. Ato janë kryesisht nëpër metropole dhe një pjesë e tyre punojnë me identitet të rremë në rrugët e Tiranës, Durrësit e Shkodrës, si shitës cigareshe sendesh të tjera deri në orët e vona të natës. Projekti i Ministrisë së Arsimit që vazhdon prej 10 vjetësh, nën titullin Shansi i Dytë, dhe projektet me mësimdhënie nëpërmjet internetit të paguara nga BE, nuk kanë sjellë asnjë përparim në rehabilitimin apo edukimin e tyre. E vetmja zgjidhje mbetet lirimi pa kushte i tyre nga ngujimi, sepse ngujimi i fëmijëve bie në kundërshtim si me ligjin, me lirinë dhe të drejtat e e njeriut, ashtu dhe me kanunin. Asnjëri nga projektet e fincuara nga qeveria dhe komuniteti ndërkombëtar nuk i ka ndihmuar fëmijët e ngujuar.

Po kështu ndodh edhe me projektet për trafikimin e grave e vajzave që sjellin hasmëri të mprehta tek familjet shqiptare. Numri i grave dhe vajzave shqiptare që i nënshtrohen prostitucionit të fshehtë për të mbijetuar, është më i larti në rajon. Në këtë aferë, shpesh ato përballen me dhunën e rrezikun e lartë ndaj jetës. Në dy vite e fundit qytetarët ndjehen të frikësuar përballë krimit të cilin nuk mund ta denoncojnë sepse rrezikohen më shumë nga denoncimi. Ngjarjet në fshatin Nartë, ku gratë dhunoheshin prej vitesh dhe nuk denonconin nga frika, është vetëm maja e aisbergut të krimit të paraportuar që ndodh në Shqipëri.

Dëmtimi i perspektivës

Shitja e pasurive kombëtare me çmime të ulta si, tokat me vlerë, bankat, telefonitë, energjia elektrike, minierat, burimet ujore, zonat turistike, etj, ka dëmtuar perspektivën ekonomike të familjeve shqiptare. Prerja e pyjeve, prishja e sistemit kullues, prishja e lumenjve dhe relievit kodrinor, ndotja e ambjentit, ndërtimet pa kriter në bregdet kanë asgjësuar mundësinë e zhvillimit të turizmit, bizneseve, dhe prodhimit agrikultural e blegetor.

Ligji 7501 për ndarjen e tokës bujqësore, i miratuar me konsensus parlamentar, ka abandonuar prodhimin në fshat dhe ka krijuar mosmarrëveshje, konflikte e hasmëri dhe mbi 50 % e tyre ndodhin midis familjeve me lidhje gjaku. Ky ligj i ka ndarë tokat duke përjashtuar nga e drejta e zotërimit pjestarët e familjes që banonin në qytet. Kjo ndarje është bërë në ngastra të veçuara dhe jo në bllok për secilën familje. Me këtë ndarje ato nuk mundet të jenë rentabël prandaj dhe shumica e popullsisë i ka braktisur duke i lënë djerr. Nga mosmarrëveshjet për tokën mbeten në konflikt të hapur në gjykatë rreth 120 000 çështje, 30 mijë prej të cilëve janë tërhequr për ta zgjidhur çështjen jashtë procesit gjyqësor, e në shumë raste këto mosmarrëveshje shkaktojnë zinxhir vrasjesh e hasmërish.

Pushteti lokal (rrethet e qarqet) nuk kanë strategji për zhvillimin e ekonomive të familjeve në fshat dhe as plane urbane për qytetet. Kaosi urbanistik ka pushtuar metropolet dhe fushat me ndërtime pa leje duke penguar prodhimin, zhvillimin ekonomik të të gjithë vendit dhe jetën normale të qytetarëve, veçanërisht të fëmijëve në qytete, të cilët nuk kanë as oborre për të luajtur as hapësira të gjelbra për shëtitje e trotuare.

Projektet për romët dhe familjet në hasmëri

Ashti si dhe familjet në hasmëri, grupet etnike rome e egjiptiane mbeten të dhunuara e në varfëri ekstreme, pa punë, pa strehim e pa përkrahje sociale. Shpesh herë romët e egjiptianët nxirren forcërisht edhe prej banesave të tyre. Shteti nuk ka marrë asnjë masë për strehimin, punësimin e integrimin e tyre në shoqërinë shqiptare dhe mbrojtjen e kulturës dhe trashëgimisë së tyre. Fondet e Bashkimit Europian dhe të donatorëve për romët ashtu si ato për familjet në gjakmarrje nuk kanë shkuar kurrë tek ato. Këto fonde përvehtësohen nga individë që krijojnë lehtësisht shoqata, institute e fondacione fantazemduke hartuar projekte boshe por që janë sipas standarteve që kërkojnë donatorët. Keta të fundit i derdhen fondet pa vigjilencë dhe pa ditur se cili është kapaciteti i individit apo organizatës që i merr këto fonde. Në shumë raste organizatat dhe individët që financohen nga donatore janë të lidhur ngushtë me njëzëri dhe specialiste që punojnë me këta donatore, për qëllime përfitim dhe në konflikt të pastër interesi.

Mohimi i të drejtës për jetën

Vlera e heqjes së dënimit me vdekje

Respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, i pasqyruar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, përcakton mbrojtjen e të drejtës së jetës prandaj ekziston edhe detyrimi parësor dhe kushtetues i shtetit, që ta respektojë dhe ta mbrojë këtë të drejtë mbi të gjitha të drejtat. Përballë vrasjeve të shumta, mbi 90 % e shqiptarëve, përfshirë dhe përfaqësuesit e partive politike parlamentare kanë deklaruar se pranojnë dënimin me vdekje si masë parandaluese. Kjo mendësi është kundërshtuar nga të gjitha forumet e Komitetit të Pajtitimit Mbarëkombëtar duke theksuar se mbështetja ndaj rikthimit të dënimit me vdekje është mbështetje ndaj hakmarrjes primitive e gjakmarrjes nëpërmjet shtetit. Komiteti i Pajtitimit Mbarëkombëtar e konsideron heqjen e dënimit me vdekje si një risi të europës dhe mesazh

shumë të rëndësishëm për njerëzimin. Kongresi i parë, i dytë, dhe i tretë i misionarëve të pajtimit e kanë përshëndetur vendimin e Këshillit të Europës.

Amnesty International e ka konsideruar dënimin me vdekje si mohimi i fundit i të drejtave të njeriut, si vepër mizore, çnjerëzore dhe degraduese, e bërë në emër të drejtësisë e të shtetit që shkel të drejtën e jetës të shpallur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Dënimi me vdekje nuk duhet të jetë në bindjen e asnjë shqiptari si një e drejtë e shtetit dhe e shoqërisë. Edhe Kanuni kërkon ndalimin e gjakmarrjes duke vendosur faljen e pajtimin si një detyrim madhor të shoqërisë dhe të çdo individ. Përvoja botërore ka treguar se edhe në ato vende ku aplikohet dënimi me vdekje, numri i vrasjeve dhe i krimeve është me i lartë se në vendet që kanë pranuar heqjen e këtij dënimi. Tendencë botërore është që ky dënim të mos egzistojë më në shoqërinë njerëzore. Dënimi me vdekje nuk garanton as vendosjen e drejtësisë, as ndalimin e vrasjeve. Institucionet shtetërore, shoqëria shqiptare, mediat, universitetet publike a private duhet të bëjnë më shumë në drejtim të përpunimit, sensibilizimit dhe emancipimit të opinionit publik për rëndësinë e heqjes së dënimit me vdekje.

Ndalimi i lirisë dhe i të drejtave të tjera.

Nëpërmjet gjakmarrjes e ngujimit kufizohen shumë të drejta kushtetuese përfshirë dhe e drejta e votës. Pavarësisht se në Shqipëri kjo e drejtë është dhunuar sistematikisht nga partitë politike parlamentare, qytetarët e ngujuar kanë të drejtën ta ushtrojnë atë. E drejta e çdo shtetasi, për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur, sipas nenit 45 të Kushtetutës, duhet garantuar nga ligji. Po kështu, sipas Kushtetutes, secili është i lirë të zgjedhë fenë ose bindjet si dhe t'i shfaqë ato individualisht ose kolektivisht në publik nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve. E megjithatë këta individë të ngujuar e kanë të pamundur të marrin pjesë në ushtrimin e këtyre praktikave. Liria e organizimit është një tjetër e drejtë kushtetuese që ka rëndësinë e vet thelbësore në krijimin, zhvillimin dhe ruajtjen e demokracisë. Nisur nga kjo situatë Komiteti i Pajtitimit Mbarëkombëtar i ka kushtuar shumë rëndësi mobilizimit të faktorëve që familjet e ngjuara të marrin pjesë si gjithë qytetarët e tjerë në votime duke insistuar që të sigurohen kutitë e lëvizshme në rastet kur këto familje nuk mund të lëvizin.

Ashtu si dhe në periudhat e mëparshme, edhe ekspedita e vitit 2013, e cila filloi me dt. 6 Janar dhe vazhdoi gjatë fushatës elektorale, krahas punës për mbajtjen nën kontroll të familjeve në hasmëri, nxiti qytetarët për një pjesëmarrje sa më të gjerë dhe të kulturuar në procesin e votimit. Nga 1208 familje të ngjuara e 3800 të fshehura nga hasmëri të ndryshme, u bë e mundur që 260 nga familje të fshehura dhe 47 të ngjuara të shoqëroheshin nga misionarët për në qendrën e votimit. Për shkak se kërkesa e Komitetit për aplikimin e kutive të lëvizëshme të votimit u refuzua nga KQZ, shumica dërmuese e qytetarëve të përfshirë në hasmëri u privuan nga e drejta e votës. Mijëra familje të tjera që kanë konflikte të tokave në fshat, dhe kanë lëvizur në metropole pa e ndryshuar gjendjen civile, e kanë pasur të vështirë që të shkojnë në zonat ku kanë vendbanimin dhe regjistrimin e tyre si votues për të mos u përballur me hasmin.

Qytetarët e ngjuar e të fshehur nuk mundën të kishin besim për garancinë e jetës. Mospbesimi për të lëvizur drejt qendrave të votimit bazohej tek përvojat e hidhura të krijuara një vit më parë nga vrasja e Gentian Beqirit kur ai ishte në arrest shtëpie dhe ruhej nga dy oficerë të policisë, të Rolanda Dokut që kishte një urdhër mbrojtje të policisë me vendim gjykatë apo të Frederik Marku dhe djalit të tij, Jurgen Marku, që u vranë sapo kishin dalë nga komisariati i policisë ku kërkuan mbrojtje.

Emigracioni

Për shkak të kërcënimit nga vrasjet për hakmarrje dhe mungesës së mbrojtjes në Shqipëri qytetarët detyrohen të largohen nga vendi. Nëse nuk është bërë i mundur pajtimi, kjo

zgjdhje ka qenë e vetmja rrugë shpëtimi në këto vite tranzicioni. Vendet perëndimore kanë dhënë kontribut për familjet që emigrojnë nga hasmëria duke i marrë në mbrojtje dhe dhënë të drejtën e azilit. Në shumicën e rasteve komisionet e azilit dhe gjykatat e emigracionit kanë marrë në mbrojtje këto familje duke pasur asistencën e Komitetit të Pajtitit Mbarëkombëtar.

Në tre vitet e fundit për shkak të krizës ekonomike që ka prekur shumë vende, dhe shtimit të emigrantëve në vendet e perëndimit shumë familje shqiptare të rrezikuara nga gjakmarrja janë refuzuar dhe deportuar. Vendimi për refuzimin e tyre ka ardhur edhe si rezultat i shtimit të vertetimeve të lëshuara për gjakmarrje nga individë të paautorizuar që kanë krijuar formalisht pseudomisione apo pseudoinstitute "Pajtimi" për përfitime nëpërmjet mashtrimit. Sipas rekomandimit të qeverisë shqiptare nr. 10/7/ prot, dt 10/7/2009 dhe nr. 1716, dt 29/9 2009, MPÇSSHB, të gjitha institucionet vendore e ndërkombëtare duhet ti referohen Komitetit të Pajtitit Mbarëkombëtar për verifikimin e çështjeve të hasmërive dhe konflikteve për gjakmarrje me qëllim eliminimin e të dhënave fiktive dhe abuzimeve. Asnjë organizatë tjetër apo institucion shtetëror shqiptar nuk është i autorizuar për lëshimin e këtyre vertetimeve pa dalë një vendim i ri që shfuqizon këto rekomandimet sepse ato janë dokumente zyrtare të qeverisë shqiptare të dala mbas konkluzioneve të kongreseve dhe konferencave kombëtare të misionarëve të pajtitit.

Sipas këtyrerekomandimeve të qeverisë si dhe rezolutave të kongreseve dhe konferencave kombëtare të misionarëve të pajtitit, Komiteti i Pajtitit Mbarëkombëtar është forum drejtues i të gjitha organizatave dhe misioneve të pajtitit dhe ka struktura të plota në të gjithë territorin e Shqipërisë, në Kosovë, Maqedoni dhe Malin e Zi për të ndjekur me përparësi të gjitha rastet e gjakmarrjes. Asnjë institucion, organizatë apo individ nuk e ka këtë kapacitet dhe eksperiencë prandaj dhe është vendosur që çështjet të arkivohen e ndiqen nga Komiteti, dhe nëse nuk ka dosje në Komitet, asnjë vertetim nuk duhet të merret në shqyrtim nga gjykatat e emigracionit dhe komisionet e azilit. Çdo vit janë marrë në mbrojtje 40 – 50 çështje që kërkojnë të drejtën e azilit, por në vitin 2011 sekserë e trafikantë që krijuan pseudoshoqata për qëllime përfitimi, dërguan brenda një kohe të shkurtër vetëm në Bruksë 400 familje për të kërkuar azil me vertetime të pa arkivuara në Komitet, në një kohë që Komiteti atje kishte vetëm 7 familje që kërkonin mbrojtje. Me qëllim që vertetimet e lëshuara nga trafikantët të mos zbuloheshin nga oficerët e emigracionit siç ishte vepruar më parë, drejtues të lartë të inkriminuar në Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Drejtësisë si dhe në Policinë e Shtetit të lidhur me sekserët, kanë inskenuarherë pas here akuza të rreme kundër Komitetit të Pajtitit Mbarëkombëtar që nga Dhjetori i vitit 2011 e në vazhdim.

Mosfunksionimi i ligjit për veprën e gjakmarrjes dhe dhunës ndaj grave.

Përballë gjendjes që ka dalë jashtë kontrollit dhe presionit publik, qeveria u mjaftua në fillim të vitit 2013 me miratimin e ndryshimeve në ligj që rrisin masën e dënimit për vrasjet për gjakmarrje, vrasjet në familje si dhe të tek ato për shkak të detyrës. Që nga miratimi i këtij ligji këto vrasje janë bërë më intensive dhe nuk duket që ligji të ketë patur ndonjë efekt. Ministria e Drejtësisë ka gabuar me nocionin vrasje për gjakmarrje dhe nuk e njeh gjendjen as shkakun e këtyre vrasjeve.

Vrasjet në Shqipëri teknikisht nuk janë vrasje për gjakmarrje por vrasje me vetëgjyqësi, në mungesë të drejtësisë dhe të shtetit të së drejtës. Asnjë nga vrasjet gjatë tranzicionit nuk ka qenë sipas rregullave të gjakmarrjes. Komiteti i Pajtitit Mbarëkombëtar ka kërkuar që nocioni i vrasjes për gjakmarrje, edhe pse perdoret për të shpjeguar një fenomen social të ditëve të sotme, të mos futet në kodin penal sepse gjakmarrja si term kanunor nuk ka bazë reale për legjislacionin e ri modern, as në kushtet e sotme të tranzicionit të shoqërisë shqiptare. Vrasjet me vetëgjyqësi nuk janë gjakmarrje. Kjo politikë e paqartë e ligjvënësive i ka futur qytetarët dhe institucionet e shtetit në qorrsohak.

Për të qenë më efikas ligji duhet të shpreht qartë e me penalitet maksimal për vrasjen. Pra çdo vrasje me paramendim duhet të ketë dënimin maksimal, jo më pak se 25 vjet burg deri në burgosje të përjetshme pa të drejtë amnistie. Ligji i ri që penalizon me dënim maksimal vrasjen për gjakmarrje nuk penalizon në këtë nivel vrasjen fillestare që shkakton gjakmarrjen ose e nxit atë. Logjika është në kundërshtim si me të drejtën ashtu edhe me procedurën penale për parandalimin e vrasjeve. Me pranimin e krimit, atyre që kryejnë vrasjen e pare që fillon zinxhirin e gjakmarrjes, u zbriten 8 vjet nga ky dënim. Me përfitime të tjera nga ligji kjo masë dënimi zakonisht shkon nga 8 deri në 12 vjet. Ky lloj handikapi nuk e zgjidh problemin e vrasjeve me vetëgjyqësi por e komplikon atë me tepër. Komiteti i Pajtitimit Mbarëkombëtar ka përgatitur dhe do i paraqesë qeverisë së re relacionin për reformën ligjore për të eliminuar këto kontradikta në kodin penal dhe në sistemin e drejtësisë, por duke ditur se krimin nuk e parandalon vetëm ligji apo forca e policisë. Në këtë aspekt ndërgjegjësimi i qytetarëve për nevojën e kulturës së ligjitëshhtë e vetmja zgjidhje afatgjatë e problemit.

Dekreti i Kishës Katolike

Mbas shpalljes së dekretit të Kishës Katolike në Metropolinë e Shkodrës, Sapës e Lezhës për shkishërimin e vrasësve për gjakmarrje, nuk ka pasur përmirësim të situatës së vrasjeve. Komiteti i Pajtitimit Mbarëkombëtar e ka mbështetur dëshirën e mirë që ka frymëzuar këtë dekret por e sheh më të arsyeshme që Kisha Katolike të mbajë qëndrim ndaj çdolloj vrasje e dhune.

Procesi i pajtitimit është në themel i bazuar në konceptin e faljes, i cili është një koncept thelbësor në shumë doktrina fetare, duke përfshirë këtu edhe Kishën Katolike. Prandaj ne mendojmë se është e rëndësishme që Kisha të afrojë qytetarët për edukimin e tyre me dashurinë për jetën, faljen dhe të parandalojë vrasjet edhe më mesazhet e saj për paqe dhe harmoni. Misionarët e pajtitimit kanë gjetur përherë mbështetjen e klerit në përpjekjet e tyre dhe e konsiderojnë këtë mbështetje si mjetin më thelbësor në shumë procese pajtimi midis familjeve të ndryshme.

Vendimet e Kongresit

Nisur nga situata e konflikteve e hasmërive në shoqërinë shqiptarë rezultatet e punës së vazhdueshme të ekspeditave të pajtitimit, nga përvoja e krijuar e të gjithë misionarëve dhe mbështetja qytetare ndaj punës së tyre kongresi vendosi:

1 – Të mbështesë planin e qeverisë për vendosjen e rendit në 300 ditët e ardhshme, sepse vendosja e rendit është parësore për të ulur numrin e vrasjeve me vetëgjyqësi, të cilësuar për gjakmarrje dhe të mbështesë procesin e pajtitimit duke patur parasysh se vendosja e rendit nuk zgjidh përfundimisht problemin e gjakmarrjes në Shqipëri pasi konfliktet zgjidhen përfundimisht vetëm kur procesi i pajtitimit është përfunduar. Kur situata e krimeve ka qenë më në kontroll, si periudha 2005-2008, është ulur edhe numri i vrasjeve për gjakmarrje, por pa u shuar plotësisht sepse konfliktet dhe vrasjet për gjakmarrje kanë vazhduar. Në rolin e tyre si pjesë e shoqërisë civile, misionarët e pajtitimit, nëpërmeet forumeve të tyre drejtuese, do të monitorojnë, asistojnë procesin e vendosjes së rendit. Në rast mungese vullneti politik ose paaftësie në implementimin e planit qeverisës për rendin, misionarët e pajtitimit do të jenë të parët që do të ngrenë zërin dhe do të prezantojnë shqetësimet e tyre pranë çdo institucioni relevant.

2- Të nisë një ekspeditë mbarëkombëtare, në bashkëpunim me faktorë të shoqërisë civile dhe qeverisë, për lirimin pa kushte të grave dhe fëmijëve të ngjuar, që përbëjnë aspektin

më tragjik dhe absurd të vrasjeve me vetëgjyqësi. Lirimi pa kushte i grave dhe fëmijëve të ngjuar krijon dhe hapsira për lirin e të gjithë familjeve të ngjuara dhe pajtimin e konflikteve.

3 - Ti kërkojë Qeverisë Shqiptare që të rrisë nivelin e bashkëpunimit me misionarët e pajtimit për rishikimin e kuadrit ligjor mbi parandalimin e vrasjeve me vetëgjyqësi, si dhe për të punuar së bashku për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian pa gjakmarrjen.

4 – Ti kërkojë Qeverisë Shqiptare që të mbështesi procesin e pajtimit, jo vetëm për zgjidhjen e konflikteve, por edhe si një nga aspektet me positive të vendimmarrjes në komunitet dhe demokracisë aktive. Ky proces duhet mbështetur pasi është rruga më e mirë për të risjellë besimin e humbur të qytetarëve ndaj shtetit – besim që është i domosdoshëm për konsolidimin e demokracisë afatgjatë në Shqipëri.

5- Ti kërkojë cdo qytetari shqiptar, që të bëjë detyrën e tij si shtetas i Republikës, dhe të ndihmojë nismat e qeverisë dhe shoqërisë civile për parandalimin efikas të vrasjeve me vetëgjyqësi. Cdo plan i qeverisë është i destinuar të dështojë nëse secili prej nesh nuk ndërëgjegjësohet për respektimin e ligjit dhe nëse ne nuk sensibilizojmë njëri tjetrin për vendosjen e rendit. Presioni i komunitetit për rrespektimin e ligjit është forca më efektive në pajtimin e familjeve në hasmëri, dhe është nga format më të pastra të demokracisë aktive që praktikohet në vëndet më të civilizuar të botës. Kompleksiteti i fenomenit të gjakmarrjes e bën të domosdoshme përfshirjen e secilit prej nesh për ti dhënë fund një herë e përgjithmonë të tilla praktikave që nuk i kanë hije një kombi me kulturë dhe traditë shtetformuese të kultivuar ndër shekuj.

